

Njoftim për shtyp nga FRA  
Vjenë, 5 qershor 2024

## **NDALOHET SHPËRNDARJA DERI MË: 5 qershor 2024 6:00 CET**

### **Rritja e kostove të jetesës dhe e racizmit përbëjnë kërcënim për mbrojtjen e të drejtave themelore në Evropë: Raporti për të Drejtat Themelore, 2024 i FRA-së**

Të drejtat themelore të njeriut janë në rrezik në mbarë Evropën. Sipas Raportit për të Drejtat Themelore, 2024 të FRA-së, kjo vjen si rezultat i rritjes së niveleve të varfërisë, kërcënimeve të vazhdueshme kundrejt demokracisë, përhapjes së racizmit dhe sfidave në kontekstin e emigracionit. Këto kërcënime nxjerrin në pah nevojën për të siguruar një mbrojtje solide dhe të qëndrueshme të të drejtave themelore në të gjithë BE-në, veçanërisht për personat në situata të cenueshme. Raporti sugjeron se si politikëbërësit dhe shoqëria civile mund të punojnë së bashku për të luftuar kërcënimin e përjashtimit social dhe për të mundësuar një shoqëri më të barabartë dhe më të drejtë për të gjithë.

[Raporti për të Drejtat Themelore, 2024](#) i FRA-së përqendrohet te zhvillimet dhe mangësitë kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave themelore në BE gjatë vitit 2023. Këtu përfshihen:

- **Rritja e varfërisë:** rritja e kostove të energjisë dhe kostove të jetesës kanë shtyrë në varfëri 1 në 5 persona në të gjithë BE-në. Pavarësisht masave për uljen e varfërisë në nivel kombëtar, fëmijët dhe familjet e cenueshme, si familjet me një prind të vetëm, familjet rome dhe ato emigrante, janë më të rrezikuarit.
- **Rregullat e reja të emigracionit, të cilat ofrojnë mbrojtje të përforcuar të të drejtave në kufijtë e BE-së, por gjithashtu paraqesin rreziqe të reja:** në vitin 2024, BE-ja ra dakord për rregulla të reja për emigracionin dhe azilin, me qëllim një përpunim më efektiv të kërkesave për azil në kufijtë e BE-së. Rregullat e reja për monitorimin e të drejtave themelore, për mbrojtjen e fëmijëve dhe për një detyrim të qartë për të hetuar të gjitha raportimet e mbështetura në prova të shkeljeve të të drejtave ofrojnë mundësi për të përmirësuar pajtueshmërinë me të drejtat themelore, kur ato gjejnë zbatim të plotë. Në vitin 2023, mbi 4000 njerëz humbën jetën ose u zhdukën në det, duke arritur kështu numrin më të lartë në pesë vitet e fundit.
- **Kërcënimet ndaj demokracisë:** ndërhyrjet e tepruara nga shteti, veçanërisht kundër të drejtave për lirinë sindikale, të tubimit paqësor dhe të shprehjes, kërcënuan hapësirën e veprimit të shoqërisë civile. Kjo, e kombinuar me mungesën e angazhimit domethënës në çështjet publike dhe me dezinformimin, po minojnë demokracinë në të gjithë Evropën.
- **Intensifikimi i antisemitizmit:** sulmet terroriste të Hamasit në Izrael më 7 tetor 2023 dhe përgjigjja ushtarake e Izraelit në Gaza shkaktuan një rritje alarmante të kërcënimeve dhe dhunës kundrejt hebrenjve në të gjithë BE-në. Shtimi i urrejtjes dhe dhunës antisemite risolli kujtime të tmerrshme në të gjithë kontinentin.
- **Rritja e intolerancës:** intoleranca po merr përmasa në rritje në mbarë Evropën, duke prekur shumë grupe, përfshirë këtu myslimanët, personat me prejardhje afrikane,

romët dhe emigrantët. Dezinformimi dhe platformat në internet kanë përkeqësuar qëndrimet raciste dhe të polarizuara.

- **Zgjerimi i hendekut dixhital:** Rritja e përdorimit të inteligjencës artificiale (IA) dhe dixhitalizimi i shërbimeve publike rrezikojnë të shkaktojnë neglizhimin e grupeve të cenueshme, si të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, të pastrehët dhe romët. Zhvillimet legjislative, duke përfshirë Aktin për Inteligjencën Artificiale dhe Aktin për Shërbimet Dixhitale të BE-së, si dhe Konventën e IA-së të Këshillit të Evropës, synojnë të adresojnë disa nga këto sfida.

Për adresimin e sfidave të tilla, FRA-ja u bën thirrje BE-së dhe vendeve të saj lidhur me sa më poshtë:

- **Të mos lihet askush pas:** të garantohet që masat për uljen e varfërisë dhe reduktimin e kostove të energjisë, duke përfshirë ndihmën sociale dhe të strehimit, të mbërrijnë te grupet e pafavorizuara.
- **Të përforcohet mbrojtja e të drejtave themelore në kufij:** të përmirësohen praktikat e kërkim-shpëtimit për shpëtimin e jetëve në det. Të garantohen kushte më të sigurta për përpunimin e mbërritjeve të reja, si dhe të ngrihen mekanizma të pavarur për monitorimin e të drejtave në kufijtë e jashtëm të BE-së.
- **Të mbrohet shoqëria civile:** të monitorohen dhe të regjistrohen kufizimet në hapësirën e veprimit të shoqërisë civile. Të ndërmerren masa për të mbrojtur advokuesit në favor të të drejtave të njeriut, si dhe lirinë e medias. Të bëhen thirrje sistematike për ekspertizë nga shoqëria civile, duke lënë kohë të mjaftueshme për konsultim efektiv.
- **Të mbahet një qëndrim i palëkundur kundër të gjitha formave të racizmit dhe intolerancës:** të njihet dhe të luftohet racizmi sistemik dhe i rrënjosur thellë, si dhe intoleranca në shoqëritë tona. Të vazhdohet monitorimi dhe mbledhja e të dhënave të bazuara në prova, për të pasuruar më tej ligjet dhe politikat e BE-së dhe ato kombëtare kundër racizmit dhe antisemitizmit. Të sigurohet një hapësirë më e sigurt në internet për të gjithë dhe të merren masa kundër urrejtjes në internet.

#### **Citim nga Drejtorja e FRA-së [Sirpa Rautio](#):**

*“Polarizimi në Evropë po sjell përhapjen e intolerancës, duke krijuar ndasi në shoqëri, me shumë grupe të cenueshme. Rritja e varfërisë dhe kërcënimet ndaj demokracisë po nxisin më tej pasigurinë dhe tensionet shoqërore. Por, në të njëjtën kohë, Evropa ka themele të forta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ku mund të bazohet për orientimin e masave. Ne të gjithë duhet të bashkohemi dhe të punojmë maksimalisht për të garantuar një të ardhme të sigurt dhe gjithëpërfshirëse që respekton të drejtat e të gjithëve, dhe ku të gjithë ndihen të sigurt për të shprehur identitetin e tyre.”*

Për më shumë informacion, kontaktoni: [media@fra.europa.eu](mailto:media@fra.europa.eu) / Tel.: +43 1 580 30 653

Ky njoftim për shtyp është përkthyer nga Qendra e Përkthimit për Organet e Bashkimit Evropian, por nuk është korrigjuar nga ekspertët e FRA-së.